

Monitorim Periodik Ndërkombëtar (tetor 2018)

Raporti Institucioneve të Interesuara për Shqipërinë

«Bashkimi Demokratik i Minoritetit Etnik Grek», ΔΕΕΕΜ-ΟΜΟΝΟΙΑ përfaqëson Minoritetin Etnik Grek në Shqipëri, i cili është i njohur zyrtarisht dhe përbën minoritetin më të madh etnik në vend. ΟΜΟΝΟΙΑ u themelua me 11 janar 1991, në qytezën e Dervicianit, duke patur selinë e saj në Sarandë të Shqipërisë.

Qëllimet e organizatës, përtej përfaqësimit, janë promovimi i Kulturës Helene, mësimi i Gjuhës Greke, ruajtja e dokeve dhe e zakoneve, uniteti i anëtarëve të Minoritetit Grek, pavarësisht bindjeve politike dhe ruajtja e identitetit kombëtar të minoritetit, nëpërmjet gjuhës, historisë dhe kulturës.

Vasilis Kagios

Kryetar i

ΟΜΟΝΟΙΑΣ

Bashkimi Demokratik i Minoritetit Etnik Grek

Email: contact@deem-omonoia.org

Tel: +355 85220110

Adresa: “Rruga Onhezmi” Sarandë

Shqipëri

Gjatë Monitorimit të Dytë Periodik Ndërkombëtar Republikës së Shqipërisë iu adresuan këto rekomandime:

- Të ratifikojë Hartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare.
- Të intensifikojë dialogun me individë që u përkasin minoriteteve kombëtare, për mundësitë e mësimit të gjuhëve minoritare dhe në gjuhët minoritare dhe, ku është e nevojshme, të bëjë hapat e duhura për të përballuar mungesat e çdo lloji.
- Të zgjerojë mundësitë e arsimit të minoriteteve, duke përfshirë mësimin e gjuhëve minoritare, të promovimit të identiteteve të veçanta dhe të mbështetjes së kulturës të minoriteteve.
- Gjatë përpilimit të ligjit të ri për ndarjen administrative dhe territoriale të marrë plotësisht parasysh Hartën Evropiane të Administrimit Vendor të Këshillit të Evropës dhe nenin 108 paragrafi 2 të Kushtetutës së Shqipërisë.
- Të vazhdojë të ndërmarrë përpjekje për të inkorporuar të drejtat e minoriteteve të vendit në politikat publike dhe në kuadrin ligjor.
- Të shqyrtojë mundësitë e adoptimit të një kuadri ligjor të plotë për minoritete kombëtare, që do të rregullonte, përveç të tjerave, kriteret ligjore të njohjes së minoritetit kombëtar, kuadrin ligjor për përballimin e problemeve të minoriteteve dhe strukturimin institucional të dialogut me përfaqësuesit e minoriteteve kombëtare.
- Të garantojë të drejtat e minoriteteve, të përpilojë dhe të zbatojë një kuadër ligjor dhe rregullator për respektimin dhe mbrojtjen e popullsisë vullnerabel.
- Të përfshijë në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë pyetje për identitetin kombëtar.
- Të hulumtojë mënyra alternative që do të sigurojnë se anëtarët e minoriteteve kombëtare/ose nacionale-gjuhësore do të kenë mundësi të ruajnë identitetin e tyre, duke mbrojtur në këtë mënyrë respektimin e të drejtave analoge të tyre.
- Tu garantojë në praktikë, personave që u përkasin të gjithë minoriteteve në të gjithë Shqipërinë, akses të barabartë në të drejtat e tyre, veçanërisht në të drejtën për arsimimin në gjuhët minoritare dhe të mësimit në gjuhët minoritare.
- Të zbatojë masa që përfshihen në Vendimin që adoptoi se fundmi, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës për zbatimin nga ana e Shqipërisë të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, veçanërisht ta atyre me të drejtat e minoriteteve për vetëdeklarimin, gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për arsimimin në gjuhët minoritare në të gjithë territorin e Shtetit.
- Të garantojë së të gjithë anëtarët e minoriteteve kombëtare dhe gjuhësore edhe nëse janë të njohura si të tilla edhe nëse jo, do të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre shoqërore dhe do të mbrohen nga diskriminime të çfarëdolloj forme.
- Të forcojë akoma më shumë përpjekjet për përballimin e problemeve minoritare, me qëllim kapërcimin pengesat e mbetura për zbatimin e plotë të të drejtave njerëzore të minoriteteve si pjesë e disa shtresave nga më të prekura shoqërore.

1. Në dritën e përgatitjes për Raportin Ndërkombëtar të Monitorimit (UPR) për Shqipërinë dhe nga ana e Bashkimit Demokratik të Minoritetit Etnik Grek «OMONOIA», na lejoni, Shkëlqesi, t'ju prezantojmë qasjen tone mbi problemet jetike që lidhen me mbijetesën dhe mirëqenien e Minoritetit Etnik Grek në Shqipëri.

A. Ligji i ripërmbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare

2. Qeveria Shqiptare, pas një kohe relativisht të gjatë konsultimi, adoptoi dhe Parlamenti Shqiptar votoi në tetor të vitit 2017 Ligjin e ri për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. «OMONOIA» si organizata që përfaqëson minoritetin më të madh në vend, mori pjesë, me besimin pozitiv, në të gjitha konsultimet parapërgatitore, që u paraprinë adoptimit të ligjit, duke prezantuar qasjen e saj. Ndërkohë, teksti përfundimtar i Ligjit, nuk mori parasysh asnjë nga propozimet tona.
3. Përveç kësaj, Ligji i ri parashikonte që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi, Qeveria Shqiptare do të duhej të adoptonte akte ligjore dhe nënligjore zbatuese. Ndërkohë, sot, **pothuajse më shumë se një vit pas adoptimit të Ligjit**, Qeveria Shqiptare **nuk ka botuar akoma ligjet zbatuese**, nga të cilat presim të shërojnë disa dispozita problematike të Ligjit, siç është **vetëdeklarimi, përdorimi i gjuhës Minoritare dhe e drejta e arsimimit në gjuhën amtare**. Gjatë diskutimit në Komitetin për Minoritetet Kombëtare, Përfaqësuesja e Minoritetit Etnik Grek shprehu kundërshtimin e ashpër ndaj propozimeve të Qeverisë Shqiptare, siç ato përshkruhen në projektet e ligjeve zbatuese. Veçanërisht:
4. **E drejta e vetëdeklarimit (Nenet 6&7)**.Ligji i ri për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare në Shqipëri **ngre shqetësime në lidhje me garantimin efektiv të të drejtave të minoriteteve në të gjithë vendin**: Ky ligj vazhdon traditën e shtetit Shqiptar në kufizimin e kuadrit gjeografik mbrojtës të minoriteteve, të paktën sa i përket Minoritetit Etnik Grek. Kjo ndodh pasi e ndërvar ushtrimin e së drejtës së vetëdeklarimit me të dhënat rreth kombësisë, që përmban Zyra e Gjendjes Civile (neni 7 paragrafi 1) dhe nga kuadri ligjor rreth Regjistrimit (Censusit) (neni 6 paragrafi 1).
5. Në këtë kuadër duhet të rikujtojmë se, deri më sot, politikat ndaj minoriteteve në Shqipëri përcaktohen nga teoria dhe praktika e **“zonave minoritare”**, të cilat janë planifikuar arbitrarisht në formën e tyre të sotme nga diktatura komuniste e Hoxhës , ekzistencën e të cilave qeveritë e mohojnë kategorikisht, por vazhdojnë de fakto t'i zbatojnë. Deri më sot qytetarët shqiptarë me origjinë greke mund të ushtrorjnë (disa) të drejta minoritare vetëm në qoftë se janë banorë të 99 fshatrave (që përbëjnë “zonat minoritare” të sipërpërmendura). Vetëm këta persona janë regjistruar si anëtarë të Minoritetit Grek në Regjistrat Civile. Si rrjedhim, “vertetim” relativ ekziston vetëm për këta.
6. Kjo është arsyeja, për të cilën akoma edhe anëtarët më të shumtë të Minoritetit Etnik Grek nuk janë në gjendje të ushtrorjnë të drejtën themelore të vetëdeklarimit në kuadrin e ligjit të ri për minoritetet, nisur nga fakti se vendlindja e tyre u izolua nga “zonat minoritare” me 1945 dhe në të gjitha dokumentet e tyre, janë regjistruar si të **Kombësisë Shqiptare**. Kjo praktikë është në fuqi për banoret e një numri të madh fshatrash më numër të dendur banoresh me kombësi Greke, siç janë Himara, Narta, Palasa, Dhrimadhes, të cilëve u mohohet e drejta e vetëdeklarimit.

7. Referimi në ligjin për minoritetet **në ligjshmërinë rreth regjistrimit** sa i përket ushtrimit të së drejtës së personit për të deklaruar se i takon një minoriteti etnik i shërben të njëjtit qëllim. Ligji në fuqi për regjistrimin u ndryshua vetëm tre muaj para regjistrimit të vitit 2011, duke përfshirë gjobë 100.00 lek (700 Euro) për përgjigje të gabuara në anketë duke përcaktuar njëkohësisht se një përgjigje do të quhet “e gabuar” në qoftë se nuk korrespondon më të dhënat që përfshihen në Regjistrin Civil. Duke e konsideruar si akt që u mohonte të drejtat e tyre, minoritetet e bojkotuan procesin dhe e dënuan regjistrimin.
8. Për këtë rast, duhet shënuar se Komisioni Këshillimor i Konventës – Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve, në Raportin e Tretë Konsultativ për Shqipërinë (që u aprovua me 23.11.2011) deklaroi se Regjistri Civil përbën një burim informacioni të pabesueshëm dhe se procedura e regjistrimit nuk ishte konform me parimin e vetëdeklarimit, një konkluzion të cilin e pranoi në një masë të madhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës (CM / ResCMN / (2014/1).
9. Në këtë “burim të pabesueshëm informacioni” (Regjistrat Civile të Shqipërisë) dhe në këtë ligjshmëri të zhvlerësuar rreth regjistrimit, ligji i ri shqiptar për mbrojtjen e minoriteteve **bazon në vetvete ushtrimin e së drejtës për vetëdeklarimin**, themelin mbi të cilin është ndërtuar çdo e drejtë minoritare.
10. Në këtë mënyrë, përzgjedh të përjetësojë në vend që të përballojë, mungesa serioze sa i përket mbrojtjes së minoriteteve, të cilat për vite me radhë kanë qenë objekt kritike të qëndrueshme nga organizmat kompetente ndërkombëtare.
11. Rrjedhimisht, nga këndvështrimi ynë:
 - Identifikimi nga Regjistri Civil nuk duhet të kufizojë në asnjë mënyrë të drejtën e vetëdeklarimit për cilindo qytetar shqiptar, një e drejtë që duhet të ushtrohet në të gjithë Shqipërinë dhe jo vetëm brenda zonave gjeografike të caktuara (“zona minoritare”).
 - Abrogim i nenit 20 paragrafi 1 i Ligjit për Regjistrimin i vitit 2011 që parashikon gjobë për përgjigje të gabuara në anketë dhe parashikonte që një përgjigje mund të konsiderohej e gabuar në qoftë se nuk korrespondojnë më të dhënat që përmban Regjistri Civil.
 - E drejta e vetëdeklarimit do të duhet të ushtrohet nëpërmjet një deklarimi të përgjegjshëm personal (element subjektiv) duke marrë parasysh kritere objektive, sidomos karakteristikat gjuhësore dhe fetare.

a) E drejta e arsimimit në gjuhën minoritare (neni 13)

12. Ligji (neni 13) parashikon që: *“Personat që u takojnë minoriteteve etnike kanë të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat banojnë tradicionalisht ose në numra të konsiderueshëm nga persona që u përkasin*

minoritete etnike duhet të sigurohen mundësitë të mësimin ose të arsimimit në gjuhën minoritare, në varësi të legjislacionit korrespondues në fushën e arsimit”.

13. Ndërkohë, zgjerimi i Bashkive, si rezultat i ndarjes/reformës administrative të vitit 2014, e bën jashtëzakonisht të vështirë zbatimin e kuotës minimale prej 20% nga minoritetet kombëtare. Përkundrazi, e konsiderojmë imediat zbatimin e kësaj të drejtë në qoftë se pragu/banim tradicional 20% nga minoriteti ndodh në nivelin njësie administrative më të vogla (kufijtë administrativë të të cilave përkojnë me ato të ish komunave/Bashkive).
14. Në këtë kuadër, Komiteti Konsultativ i ftoi autoritetet shqiptare “të zbatojnë kriteret për një hapje të manovrueshme të një klase në gjuhën minoritare dhe të shqyrtojnë mënyra thjeshtëzimi të sistemit”. Përpos kësaj, i ftuan autoritetet shqiptare “të mos bazohen ekskluzivisht në të dhëna në lidhje me kombësinë që përfshihen në Regjistrat Civilë as tek rezultatet e regjistrimit të vitit 2011”, por të respektojnë parimin e vetëdeklarimit të lirë, duke marrë paralelisht parasysh si zgjedhjen subjektive ashtu edhe kriteret objektive që lidhen me identitetin e një personi, kur vendosin për hapjen e klasave në gjuhën minoritare¹.
15. Nga këndvështrimi ynë:
 - E drejta e arsimimit në gjuhën minoritare do të duhet të sigurohet **për të 12 klasat shkollore**, “në njësitë e administratës vendore ku banojnë tradicionalisht dhe në numër të konsiderueshëm personash që u takojnë minoriteteve etnike”.
 - Në shkollën fillore, analogjia e lendeve që zhvillohen në gjuhën amtare të nxënësve me lendet që zhvillohen në gjuhën shqipe duhet të jetë në favor të të parave, ndërsa në arsimin e shkollës së dytë mësimin në gjuhën shqipe do të shtohet.
 - **Hapja e një shkolle/klase minoritare** do të duhet të bëhet në nivelin e njësie më të vogla administrative (dhe jo të bashkive “të zgjeruara”), kur plotësohen numrat e konsiderueshëm ose kriteret tradicionale të banimit dhe numri i nxënësve për një klasë të jetë minimalisht 10.
 - **Tekstet për shkollat e minoriteteve** kanë nevojë për përmirësim të rëndësishëm sa i përket cilësisë dhe përgatitjes dhe dorëzimit të shpejtë.

β) Përdorimi i gjuhës minoritare (neni 15)

16. Rishtazi, besojmë se zgjerimi i Bashkive, për shkak të reformës administrative të vitit 2014, e bën emergjente sigurimin e përdorimit të gjuhës amtare në qoftë se kuota prej 205 ose banimi tradicionalisht nga minoriteti ndodh në nivelin e njësie administrative më të vogla (kufijtë administrativë të të cilave përkojnë me ato të ish komunave/bashkive. Vendimi analog duhet të merret nga Këshilli Bashkiak (duke marrë parasysh se njësitë administrative nuk kanë autonomi administrative) dhe jo nga Prefekti. Gjithashtu, Këshilli Bashkiak duhet të jetë ligjërish i detyruar të marrë këtë vendim kur plotësohen kriteret që përcakton ligji për minoritetet.

17. Emrat e “*njësive administrative, të rrugëve dhe të emërtimeve të tjera topografike*” do të duhet të shfaqen, përveç se në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën e minoritetit respektiv, jo vetëm në njësitë ku më shumë se 20% e banoreve i takojnë një minoriteti etnik (sikurse përcaktohet në paragrafin 3), por edhe në njësi të administrimit vendor ku tradicionalisht banojnë persona që i takojnë një minoriteti etnik.

Në këtë kuadër do të duhet gjithashtu të sigurohet mundësia e shfaqjes së emrit të Bashkisë në gjuhën minoritare.

Gjithashtu, termi “kërkesë e mjaftueshme” do të duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që te mos bëhet kjo dispozitë e pazbatueshme ose shumë e vështirë në praktikë (për shembull, mjafton një kërkesë nga 100 anëtarë të një minoriteti).

18. «Njësitë e administrimit vendor që banojnë tradicionalisht nga persona që i takojnë minoritetit etnik» nuk mund kenë emër të ndryshëm për ish “zonat minoritare”. Për shembull, përveç bashkive të “njohura” të Finiqit dhe të Dropullit, krahina që tradicionalisht banojnë nga persona që i takojnë Minoritetit Etnik Grek, përfshijnë gjithashtu Himarën, Nartën, Mursinë, Sarandën, Gjirokastrën, Korçën etj. Termi “i banuar jo tradicionalisht” do të duhet të shprehë krahina ku anëtarët e minoritetit banojnë, për shembull, për shkak të zhvendosjeve ose të emigrimit të brendshëm, siç ndodh me anëtarët e Minoritetit Etnik Grek në rastin e Tiranës dhe të Durrësit.

B. Mbrojtja e të Drejtave në Pronësi

19. Siç njihet gjerësisht, të drejtat e pronës në Shqipëri përbëjnë problemin më të koklavitur pas ndryshimit të sistemit në fillim të viteve 90. Veçanërisht, për Minoritetin Etnik Grek, mbrojtja e të drejtave pronësore janë të rëndësishme jetike për mbijetesën e tyre në Shqipëri.
20. Një nga problemet kryesore lidhet me legjislacionin shqiptar për shpronësimet. Sipas ligjit shqiptar, nuk është i nevojshëm vendimi i Gjykatës për vërtetimin e “interetit publik” për shpronësimin e elementeve pronësore të qytetarëve. Përkundrazi, legjislacioni për “Investimet Strategjike” parashikon shpronësimin nga shteti në favor të investitorit në rastin që negociatat midis investitorit dhe pronarit nuk përfundojnë në marrëveshje pas 90 ditësh (për prona të palevizishme bregdetare që gjenden në pjesën e vendit që paraqet në mënyrë të padyshimtë potencialin më të lartë turistik me çmime që lëvizin nga 0,6 Euro deri në 1,8 Euro për metër katror!)².
21. Është e tepërt të theksohet se dëmshpërblimi për shpronësimin është në një masë të madhe shumë më e ulët se çmimi real i tregut dhe se qytetarët humbasin pronat e tyre menjëherë pas vendimit analog të Këshillit të Ministrave dhe, në pjesën më të madhe të rasteve, pa dëmshpërblim, sepse duhet tu drejtohen gjykatave për të marrë dëmshpërblim në çmimin e tregut. Në realitet, pronarët humbasin kohen në betejë

- ligjore të zgjatura dhe të kushtueshme, derisa të marrin një vendim të formës përfundimtare nga Gjykata, i cili vendim në shumë raste është e vështirë të zbatohet.
22. Një tjetër problem i përbashkët është mosregjistrimi i titujve të pronësisë nga zyrat hipotekore. Bëhet fjalë për një fenomen të njohur, sidomos në rastin e Himarës, e cila për shkak të mundësive të mëdha për zhvillim turistik, bëhet objektiv i interesave të mëdha financiare. Një nga shembujt të mos zbatimit dhe të shkeljes të të drejtave të pronësisë të anëtarëve të Minoritetit Etnik Grekështë plani urbanistik për qytetin e Himarës.
 23. Në lidhje me këtë duhet përmendur se Avokati i Popullit i Shqipërisë, i cili pas denoncimeve të banorëve, pronat e të cilëve përballen me shkatërrime dhe shpronësime, iu drejtua me pyetje për këtë autoriteteve shtetërore që u përfshinë në këtë problem dhe konkludoi në një raport respektiv me 19 janar 2017 (dokumenti nr. 201602238/6), se plani urbanistik, për arsye të ndryshme, nuk ishte konform ligjit dhe se vendimet analoge administrative nuk kishin hyre akoma në fuqi dhe ishin të pavlefshme. Në këtë kuadër, duhet të rikujtojmë se Qeveria Shqiptare ka konkluduar më në fund të pranojë, të paktën në parim, se banorët e prekur janë realisht pronarët e sipërfaqeve dhe të ndërtesave të cilat pritet të shpronësohen (pa mundur, ndërkohe, të regjistrojnë akoma pronat e tyre). Në dhjetor të vitit 2017, Gjykata Administrative e Vlorës, në vendimin e saj, ra dakord gjithashtu se plani urbanistik i mungon ligjshmëria.
 24. Një tjetër shembull është rasti i Nivicës, në të cilin pronarët, pas një beteje të gjatë ligjore, ia arritën të dalë vendimi i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë me të cilin urdhërohet Bashkia e Himarës të japë tituj pronësorë për sipërfaqe të mëdha gjatë bregdetit. Bashkia e Himarës, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Lartë, i lëshoi tituj respektivë pronësorë, por Zyra Hipotekore e Vlorës nuk pranoi ti regjistronte.
 25. Një rast tjetër është beteja e gjatë ligjore e Bashkisë së Finiqit në lidhje me tokat e shumta bujqësore bashkiake në zonën e fshatit Kostar, të cilat pretendoheshin nga persona me tituj të dyshimtë vlefshmërie. Bashkia apeloj vendimet e mëparshme në Gjykatën e Lartë, e cila, fatkeqësisht, nuk funksionon për shkak të shkarkimit të shumë anëtarëve të tij në kuadër të procedurës së rivefikimit të gjyqtarëve.
 26. Çfarë u parashtrua më lart përbëjnë vetëm disa çështje treguese në lidhje me të drejtat pronësore të anëtarëve dhe të Bashkive të Minoritetit Etnik Grek. Nëpërmjet shpronësimeve, vendimeve qeveritare arbitrare, pengesave administrative dhe vendimeve gjyqësore të paqarta, anëtarët e minoritetit duhet të kalojnë përmes procedura të gjata dhe të koklavitura për të mbrojtur pasuritë e tyre, të cilat janë jetike për qëndrimin e tyre në vatrën atërore.